

PËRQASJE KULTURORE DYGJUHËSHE PËRMES PËRQASJES GJUHËSORE TË SHPREHJEVE FRAZELOGJIKE

Dr. Alnida Shano Koroshi

Departamenti i Gjuhës Italiane
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: alnida.shano@unitir.edu.al

Dr. Kozeta Noti

Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë
Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës
E-mail: kozeta.noti@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në këtë trajtesë, së pari kemi përcaktuar kriteret mbi të cilat do të bëhet analiza kontrastive e njësisive frazeologjike në gjuhën italiane dhe shqipe, të cilat përmbajnë elementin “sy”. Më pas kemi paraqitur një klasifikim, i cili nis nga barasvlefshmëria totale për të mbërritur tek ajo zero, e njësisive frazeologjike të marra në analizë në të dy gjuhët. Metoda kërkimore e përdorur është ajo krahasimore. Qëllimi i këtij punimi, nëpërmjet përqasjes së korpusit gjuhësor, është të nxjerrë në dukje pikëtakimet dhe dallimet të cilat pasqyrojnë vlerat kulturore të një populli, përmes gjuhës. Ky punim i vjen në ndihmë të gjithë atyre që studiojnë gjuhën italiane për një përvetësim sa më korrekt të strukturave gjuhësore si dhe të gjithë të apasionuarve të gjuhësisë. Fjalët çelës: barasvlefshmëri, frazeologji kontrastive, gjuha italiane, gjuha shqipe.

ABSTRACT

In this paper, we have firstly defined the criteria on which the contrast analysis of phraseological units in Italian and Albanian will be performed, which contain the element “eye”. Then we have presented a classification, which starts from the total equivalence to arrive at zero one, of the phraseological units taken into analysis in both languages. The research method used is the comparative one. The purpose of this paper, through the approach of the linguistic corpus, is to highlight the similarities and differences which reflect the cultural values of a people, through language. This paper is addressed to all of them who study the Italian language for a more correct acquisition of language structures as well as those that are interested in linguistics.

Keywords: Albanian, contrastive phraseology, equivalence, Italian.

Hyrje

Studimet në fushë të frazeologjisë kontrastive, me në fokus gjuhën shqipe, i gjejmë që në fillimet e shekullit XX si nga gjuhëtarë të huaj [Raffo: 200] po ashtu edhe nga studiues shqiptarë [Çabej: 174]. Përsa u përket studimeve mbi frazeologjinë kontrastive të gjuhës shqipe dhe asaj italiane, këto të fundit janë shprehur përgjithësisht përmes publikimit të fjalorëve të ndryshëm dygjuhësh [Balla: 2007].

Ky artikull, pjesë e një punimi më të gjerë, synon të evidentojë ngjashmërinë dhe natyrisht dallimet që paraqesin dy gjuhë si italishtja dhe shqipja të krahasuara ndërmjet tyre. Këtë krahasim më së miri e përcjell frazeologjia e cila mbart në vetvete vlera mjaft të mëdha kulturore e mendësie të të dy popujve.

Barasvlefshmëria e njësive frazeologjike

Përgjithësisht të gjitha tendencat përkojnë me tre nivele ekuivalencash ndërgjuhësore [Casadei: 147] ekuivalencë totale, të pjesshme dhe zero. Termi ekuivalencë ka qenë gjithmonë i lidhur me teorinë e përkthimit, por me të është marrë dhe frazeologjia kontrastive [Wotjak: 70], objekti i së cilës është të analizojë analogjitë dhe diferencat e dy sistemeve gjuhësorë të krahasuar, nëpërmjet kriterëve që shërbejnë si bazë e krahasimit ndërgjuhësor. Për ta përgjithësuar do të pohojmë se kemi dy lloj ekuivalencash, të cilat varen totalisht nga fusha e zbatimit të tyre:

- Ekuivalenca semantike ose funksionale, objekti i frazeologjisë kontrastive që mund ta përkufizojmë si kuptimin e njësive frazeologjike;
- Ekuivalenca komunikative ose tekstore, objekt i përkthimit, në të cilën luajnë një rol mjaft të rëndësishëm aspekte pragmatike si situata komunikative, regjistrat, stilet etj.

Objekti i këtij punimi sipas perspektivës së frazeologjisë kontrastive është ekuivalenca semantike e një njësie frazeologjike në L1 dhe korrespondentes së saj në L2. Aty ku nuk do të jetë e mundur gjetja e një gjegjëse në L2 atëherë do i referohemi ekuivalencës zero.

Kriteret e krahasimit

Nisur nga prezuposti se në gjuhët e marra në shqyrtim kemi ngjashmëri dhe dallime formale dhe semantike, mund të themi se dy njësi frazeologjike kanë të njëjtin kuptim frazeologjik kur kanë të përbashkët këta element [Navarro: 399]

- Kuptimin global të njësive frazeologjike;

- Strukturën morfosintaksore;
- Zgjedhjen leksikore;
- Imazhin që krijojnë.

Kur flasim për kuptimin global të njësive frazeologjike i referohemi natyrisht kuptimit tërësor të shprehjes dhe jo shumës së kuptimeve që mund të kenë elementët e saj. Këtu bëjmë dhe dallimin e njësive të motivuara dhe atyre të pamotivuara. Të parat përcaktojnë një lidhje ndërmjet kuptimit denotativ dhe atij të fjalë për fjalë p.sh., *accogliere a braccia aperte/të presësh dikë me krahë hapur; annegare in un bicchier d'acqua/të mbytesh me një pikë ujë* kuptimi i këtyre njësive është lehtësisht i gjetshëm në sajë të paralelizmave që krijohen ndërmjet rendit sintaksor dhe analizës kuptimore. Në raste të tjera, metafora nuk na e lehtëson kuptimin e shprehjes si p.sh., *alzarsi con il piede sinistro; dormire con un occhio solo; e la me duart në gji; u bë një dorë*. Këto të fundit janë rezultat i një kombinimi fjalësh ndonjëherë arkaik që në ditët e sotme e kanë humbur lidhjen ndërmjet kuptimit fjalë për fjalë të shprehjes dhe atij idiomatik. I referohemi këtu shprehjeve si *i jap dum*, sipas Gustav Majer-it *dum* vjen nga greqishtja *dhromos*, “*udhë*” pra “*i jap udhë*” [Thomai: 144]. Këto janë njësi frazeologjike të pamotivuara të cilat kanë nevojë për një reflektim *a posteriori* për të kuptuar kuptimin global të shprehjes, pasi kur motivimi është i pakët, idiomaticiteti është gjithmonë i madh.

Nga kriteret e lartpërmendura, interesi ynë është kuptimi frazeologjik si kusht i domosdoshëm për të realizuar krahasimin ndërmjet dy gjuhëve të marra në analizë.

Analiza dhe shkallët e barasvlefshmërisë

Në analizë janë marrë njësitë frazeologjike të të dy gjuhëve të cilat kanë në brendinë e tyre elementin *sy*. Kjo zgjedhje u bë pasi të dy gjuhët paraqesin një sasi të madhe të këtyre shprehjeve, të cilat janë të një përdorimi të përditshëm, në mënyrë që të mund të na lejonin një analizë krahasuese. Korpusi i shprehjeve në gjuhën shqipe është marrë nga Fjalori i Shqipes së Sotme [Toena: 2002] dhe nga Fjalori Frazeologjik i gjuhës shqipe [Thomai: 1999], gjithashtu edhe për gjuhën italiane janë konsultuar Fjalori i gjuhës italiane [Lo Zingarelli: 2012] dhe ai frazeologjik [Quartu: 2001].

Objekt i këtij punimi nuk është mbledhja në tërësi e të gjitha njësive frazeologjike apo renditja e tyre në këtë punim, por vendosja e kriterëve mbi të cilat të mundësohet një punim mirëfilli krahasues, punim i paplotë deri më tani dhe që do të kërkojë në të ardhmen zgjerimin e tij dhe shtrirjen mbi të gjitha njësitë frazeologjike të gjuhëve të marra në analizë.

Njësitë frazeologjike janë analizuar dhe janë grupuar sipas shkallës së ekuivalencës që paraqesin mbështetur edhe në eksperiencën studimore të gjuhëve të tjera [Wotjak: 71].

Në këtë analizë propozojmë 7 nivele korrespondencash, duke nisur nga ekuivalenca totale për të mbërritur tek ajo zero.

1. Në grupin e parë kemi përfshirë njësitë frazeologjike të cilat na paraqesin barasvlefshmëri totale në të dy gjuhët. Kjo barasvlefshmëri lidhet së pari me kuptimin, së dyti me imazhin që vetë njësia përcjell, së treti me strukturën morfosintaksore dhe së fundmi me zgjedhjen leksikore të fjalëve në brendi të saj.

Avere davanti agli occhi – avere a portata di mano un oggetto che si stava cercando, la soluzione di un problema, o la prova evidente di qualcosa. Può essere riferito sia a qualcosa di concreto che a qualcosa di astratto.	E kam para syve – (diçka) që po kërkoj e kam në dorë apo shumë pranë por nuk më sheh syri.
Chiudere gli occhi – morire; non voler vedere una realtà in genere spiacevole, convincersi che le cose stiano in un certo modo, credere quello che fa piacere; anche tollerare una mancanza, ignorarla, fingendo di non aver visto niente poiché in quel momento si tenevano gli occhi chiusi.	Mbylli sytë (dikush) – nuk vuri re asgjë ose bëri sikur nuk shikonte; nuk mori parasysh asnjë vështirësi a rrezik, u hodh në rrezik pa vënë re asgjë; vdiq, mbaroi.
Non credere ai propri occhi – stentare a credere quanto si vede nonostante la prova della sua realtà fornita dalla vista. Si dice di qualcosa d’impensato, d’insperato, che comunque suscita meraviglia, stupore.	S’u beson as syve të vet (dikush) – kërkon t’i vërtetojë e t’i saktësojë mirë gjërat, është shumë i kujdesshëm e nuk beson asgjë pa e vërtetuar mirë; është mosbesues.

Tabela 1. Njësi frazeologjike të njëjta

Avere davanti agli occhi/e kam para syve janë dy shprehje të tjera të njëjta të cilat hapin grupin e shprehjeve me elementin *sy*. I referohen situatës kur jemi duke kërkuar diçka konkrete por nuk arrijmë ta gjejmë megjithëse e kemi para syve. Kjo mund të jetë si rezultat se jemi shumë të lodhur apo jemi të hutuar për shkak të një problemi që kemi dhe mendimet apo shqetësimet tona nuk na lënë të shohim atë që është mjaft e dukshme e që ndodhet pikërisht para syve tanë. Mund t’i referohen një objekti konkret apo një ideje abstrakte. *Chiudere gli occhi* në gjuhën italiane si kuptim të parë mbart konceptin e vdekjes, pra të mbyllësh përgjithnjë sytë e të ndahesh nga jeta, ndërsa si kuptim të dytë, do të thotë të mbyllësh qëllimisht sytë para diçkaje pasi nuk do të bëhesh pjesë e saj apo nuk do të pranosh një të vërtetë të hidhur e kështu sytë mbahen mbyllur pikërisht për të penguar pamjen. Në gjuhën shqipe me shprehjen *mbylli sytë* kemi një përmbyasje të rendit të kuptimeve, të mbyllësh qëllimisht sytë para një rreziku të madh e të hidhesh në veprim pa llogaritur rreziqet është kuptimi i parë i shprehjes e të ndahesh nga jeta është kuptimi i dytë. *Non credere ai propri occhi/s’u beson as syve të vet*, sërish dy shprehje të tjera të njëjta të cilat mbartin imazhin e dikujt që përpara një fakti real megjithëse sheh provat e asaj që ka

ndodhur nuk mund ta besojë që është e vërtetë pasi ajo që pritej të ndodhte megjithëse shumë e dëshiruar dukej se ishte e pamundur. Shpesh i referohet dikujt që është shumë mosbesues edhe atëherë kur nuk është e nevojshme duke e ironizuar kështu situatën apo duke e bërë atë qesharake.

2. Në grupin e dytë barasvlefshmëria e njësive frazeologjike nuk është më totale por e pjesshme. Këtu kemi grupuar ato shprehje me të njëjtin kuptim, pra kuptimi denotativ i njësive sërish shërben si kriter kryesor për seleksionimin e tyre. Imazhi që ato përfaqësojnë sërish është i njëjtë, po ashtu dhe zgjedhjet leksikore. Elementi dallues i këtij grupi është pikërisht ndryshimi në strukturën morfosintaksore. Këto ndryshime janë grupuar si më poshtë:

Covare con gli occhi – guardare continuamente, amorosamente qualcuno o qualcosa, come a volerne controllare la sicurezza, il benessere e simili.	E përpiu me sy (dikë a diçka) – ia nguli fort vështrimin e s’ia ndante, e shikoi me lakmi e me dëshirë të papërmbajtur.
Perdere d’occhio – non riuscire a vedere più qualcosa o qualcuno; anche non prestarle la dovuta attenzione, riferito per lo più all’argomento principale di un discorso, a un aspetto di una situazione o simili.	Më iku nga sytë – (dikush) u largua pa u vënë re, iku tinëz, nuk e shoh më; (diçka) më shpëtoi pa e vënë re një gabim, një të metë etj., më rrëshqiti.
Uscire dagli occhi – provocare saturazione, stancare, riferito a cose o persone che sono venute a noia per eccesso di quantità o di presenza, come se il tedio interiore fosse cresciuto a dismisura e ormai traboccasse anche dagli occhi.	Më mbiu në sy (dikush a diçka) – më del përpara aq shpesh sa më mërzi, nuk e shoh dot më.

Tabela 2. Ndryshim në numrin e elementit kyç të shprehjes, pra të gjymtyrës trupore

Covare con gli occhi/e përpiu me sy do të thotë të shohësh dikë me shumë kënaqësi, me endje, me dëshirë të zjarrtë për t’i qëndruar pranë e për ta pasur. Shohim se në njësinë në gjuhën italiane elementi kryesor (occhi) është shprehur në numrin njëjës në të shquar, ndërsa në shqip elementi kyç i shprehjes (sy) është në trajtën e pashquar në numrin njëjës.

Kur dikush të ikën nga rrezja e shikimit, kur mjafton një çast i vetëm hutimi për të mos e pasur më para syve apo ku një detaj na ka kaluar pa u vënë re mirë përdorim njësitë e mëposhtme: *perdere d’occhio* dhe *më humbi nga sytë*. Në njësinë në gjuhën shqipe elementi kyç i shprehjes është në numrin shumës në trajtën e shquar, ndërsa në gjuhën italiane është shprehur në numrin njëjës në të pashquar.

Uscire dagli occhi/më mbiu në sy përdoret kur dikush apo diçka prej një kohe të gjatë

ka qenë i pranishëm në përditshmërinë tonë dhe kështu është bërë i mërzitshëm dhe i bezdisshëm për pamjen, aq sa duket sikur pamja e dikujt apo e diçkaje na është fiksuar në sy e sikur del prej tyre. Në gjuhën italiane elementi *occhi* është në numrin shumës ndërsa në gjuhën shqipe në numrin njëjës.

Në rastet kur bëjmë një analizë të një ngjarje, apo të një personi nën një këndvështrim krejt tjetër nga sa e kemi konceptuar apo hasur më parë dhe kur kështu zbulojmë aspekte të panjohura më parë (kryesisht pozitive), atëherë përdorim këto dy njësi: *veder qualcosa/qualcuno con occhi diversi* dhe *e shoh me një sy tjetër*. Njësia në gjuhën italiane është e shprehur në numrin shumës ndërsa njësia në shqip në numrin njëjës në trajtën e pashquar.

Perdere il lume degli occhi – perdere la capacità di ragionare per ira e sim.	M'u megjulluan /errën /errësuan /veshën /verbuan/qorruan sytë – humba qartësinë e shikimit e të kuptimit të gjërave; u inatoso dhe s'vija re më se çfarë bëja.
Tenere gli occhi addosso – sorvegliare attentamente qualcuno e il suo operato, senza mai distrarsi, quasi sempre per cercare di coglierlo in fallo.	la nguli/ngjiti/qepi sytë (dikujt a diçkaje) – e shikoi me vëmendje e për një kohë të gjatë; e shikoi me ngulm, nuk ia ndau shikimin.

Tabela 3. Më shumë se një variant foljor në gjuhën shqipe

Të humbasësh aftësinë e arsyetimit nga zemërimi apo inati jepet me shprehjen në gjuhën italiane *perdere il lume degli occhi* dhe në gjuhën shqipe vjen sërish me më shumë se dy variante foljore *m'u megjulluan /errën /errësuan /veshën /verbuan/qorruan sytë*. Sytë në këtë rast kanë privilegjin e të parit si shqisë mjaft e rëndësishme në gjykimin apo arsyetimin e botës përreth.

Kuptim të njëjtë me shprehjen që lartpërmendëm *non levare gli occhi di dosso*, pra të mos ia ndash sytë dikujt, por tanimë në formën pohore kemi *tenere gli occhi addosso* dhe *ia nguli/ngjiti/qepi sytë*. Qëllimi i këtij shikimi kaq këmbëngulës është pikërisht përpjekja për të kapur dikë në gabim, sikur në atë çast që sytë nuk do ta shohin personin që jemi duke vëzhguar pikërisht atëherë ai do të bëjë një lëvizje të gabuar. Është mjaft interesante që i njëjti kuptim jepet në të dy gjuhët me shprehje në formën mohore sikurse edhe pohore, por mbi të gjitha duhet theksuar se nuk kemi përsëritje të foljeve tek asnjëra nga njësitë frazeologjike, me gjithë variantet e shumta që janë përdorur në gjuhën shqipe. Për formën mohore kemi: (nuk) *shkëpus, heq, shqis, ndaj sytë* dhe për formën pohore: ngulis, ngjis, qep sytë. Provë kjo e pakundërshtueshme e pasurisë së gjuhëve dhe e gjuhës shqipe në veçanti.

Alzare/mettere/levare gli occhi su – aspirare a un rapporto soprattutto matrimoniale con una persona di classe sociale o economica superiore; aspirare al possesso di una determinata cosa, posizione o simili; in genere, implica l’inadeguatezza del soggetto a quel dato bene, carica, situazione o simili, e a volte il suo intento ad arrivarci con qualsiasi mezzo.	Ia vuri/shtiu syrin – (diku)jt e zgjodhi midis të tjerëve për t’i ngarkuar një punë, për ta caktuar në një vend; për t’u fejuar a për t’u martuar me të etj.; (diçkaje) e lakmon ta shtjerë në dorë, vendosi të përpiqet për ta pasur.
Guardare/vedere di buon occhio – avere simpatia, benevolenza o stima per una persona, vederla volentieri; di una situazione, un’iniziativa e simili, esserne convinti, approvarla, appoggiarla.	E sheh/e ka me sy të mirë (dikë) – e shikon me dashamirësi e me simpati, ka mendim të mirë për dikë; e përkrah duke u nisur nga mendimi i mirë që ka për të.

Tabela 4. Më shumë se një variant foljor në të dy gjuhët

Alzare/mettere/levare gli occhi su ..., sërisht njësia në gjuhën italiane na paraqet tri variante foljore ndërsa shprehja në gjuhën shqipe vetëm dy të tilla, *ia vuri/shtiu syrin*. Tjetër dallim që bie menjëherë në sy është ndryshimi i numrit të elementit kyç të shprehjes, në gjuhën italiane është dhënë në numrin shumës *gli occhi* (sytë), ndërsa në gjuhën shqipe është në numrin njëjës, *syrin*. Në gjuhën italiane të ngresh sytë drejt diku(jt) krijon imazhin e një njeriu që ndodhet apo qëndron më poshtë se personi apo objekti drejt të cilit ka ngritur sytë e nënkupton idenë se ky i fundit qëndron në një pozitë më të lartë. Pra ai që i ka vënë syrin diku(jt) sidomos me qëllim për t’u martuar apo diçkaje për ta arritur apo të ra pasur, do të thotë që nuk është mjaft i përshtatshëm për këtë synim që i ka vendosur vetes, megjithatë nënkupton edhe arritjen e qëllimit me çfarëdolloj mjeti. Në shqip, t’ia vësh apo t’ia shtiesh syrin diku(jt) do të thotë të lakmosh të kesh dikë me qëllim fejeje apo martese, apo diçka për ta pasur, për ta shtënë në dorë me çdo kusht. Gjithashtu nënkupton edhe t’ia vësh syrin diku(jt) në mes të një grupi, për ta ngarkuar me një detyrë apo për ta caktuar në një vend tjetër.

Guardare/vedere di buon occhio, këtu kemi përdorimin e dy foljeve sinonimike të njëra-tjetrës, të shohësh me sy të mirë dikë. Në gjuhën shqipe kemi barasvlerësen *e sheh/e ka me sy të mirë*. Tek të dy gjuhët kemi të njëjtin kuptim, të shohësh dikë me dashamirësi, me simpati, të kesh mendim të mirë për dikë dhe si pasojë ta përkrahësh nëse është e nevojshme në një situatë të caktuar.

3. Në grupin e tretë do të gjejmë njësitë frazeologjike të cilat paraqesin kuptim të njëjtë, struktura morfosintaksore nuk përmban ndryshime thelbësore, zgjedhja leksikore është identike, gjithashtu është dhe imazhi që reflektojnë. Deri këtu duket sikur po rimarrim tiparet e grupit të parë ku ekuivalenca ishte totale. Në fakt, tipari thelbësor i këtij grupi është sinonimia. Paraqet sinonimi gjuha italiane, ajo shqipe ose të dyja së bashku. Sinonimia e shprehur në këtë grup lidhet sërish me elementët që shprehin organe, gjymtyrë apo pjesë të tjera trupore. Edhe ky grup do të jetë i ndarë në tre nëngrupe sipas sinonimisë së shprehur.

Avere gli occhi che si chiudono – avere molto sonno, essere sul punto di addormentarsi. <i>Avere le palpebre che si chiudono.</i>	Më mbyllen sytë – më flihet shumë; jam shumë i lodhur, jam i këputur; sa s'më bie të fikët nga kënaqësia.
Avere gli occhi pesanti - avere sonno, avvertire lo stimolo a chiudere gli occhi per la pesantezza delle palpebre. <i>Sentirsi gli occhi pesanti; sentire le palpebre pesanti.</i>	M'u zvogëluan sytë – më vjen për të fjetur, s'duroj më dot pa gjumë; nuk i shoh më punët aq qartë, nuk i kuptoj më aq shpejt e aq mirë.

Tabela 5. Gjuha italiane paraqet sinonimi

Avere gli occhi che si chiudono do të thotë të të mbyllen sytë për gjumë, të jesh gati duke të të zënë gjumi, ndërsa në gjuhën shqipe gjegjësjë e kësaj njësie, *më mbyllen sytë*, përveç këtij kuptimi, pra të jesh gati duke fjetur, mbart edhe një kuptim tjetër. Në fakt akti i mbylljes së syve mund të jetë për shkak të lodhjes së madhe e pra të gjumit që vjen si pasojë, por i referohet edhe rasteve kur jemi duke provuar një kënaqësi të madhe dhe kjo na çon në mbylljen e syve. Pra siç e shohim kemi një kuptim të dytë në gjuhën shqipe të cilin gjuha italiane nuk e shpreh, por duke qenë se gjuha italiane na paraqet shprehje sinonimike për këtë njësi, *avere le palpebre che si chiudono* (të të mbyllen qepallat e syrit), na u duk më e drejtë ta gruponim këtë njësi frazeologjike në këtë nëngrup.

Avere gli occhi pesanti/m'u zvogëluan sytë, këto dy shprehje nuk paraqesin të njëjtën zgjedhje leksikore, megjithëse kanë kuptim të njëjtë. Le t'i analizojmë ato. Në gjuhën italiane *avere gli occhi pesanti*, t'i kesh apo t'i ndjesh sytë e rënduar do të thotë të jesh aq i lodhur sa që edhe sytë apo më saktë qepallat e syrit të të rëndojnë, pra të jesh aq i sflitur sa që të mos mbash dot as qepallat e syrit lart. Në këtë kuptim ky veprim çon në zvogëlimin e syrit, pasi dikush që është shumë i lodhur e nuk ka fuqi të mbajë sytë hapur do të thotë që zvogëlon hapjen e qepallave duke bërë që syri të hapet më pak e si pasojë të duket më i vogël. Nga ky arsyetim del përdorimi i njësisë frazeologjike në gjuhën shqipe me foljen zvogëloj, *m'u zvogëluan sytë*, një gjetje mjaft e spikatur. Gjuha italiane paraqet edhe dy njësi të tjera me të njëjtin kuptim, *sentirsi gli occhi pesanti* (të ndjesh sytë e rënduar) dhe *sentire le palpebre pesanti* (të ndiesh qepallat e rënuara).

Aver la benda agli occhi – essere offuscato da passione e sim.	I kanë vënë sytë ag (dikujt) – i kanë vënë perde sytë; nuk i sheh qartë punët, nuk i kupton drejt gjërat; është verbuar; <i>I janë veshur sytë; iu megjulluan sytë.</i>
Avere le lacrime agli occhi – essere sul punto di piangere.	Iu njomën sytë (dikujt) – iu mbushën sytë me lot. <i>I lagu sytë (dikush).</i>

Tabela 6. Gjuha shqipe paraqet sinonimi

Kur dikush nuk i sheh gjërat qartë ashtu siç janë apo nuk arrin t'i kuptojë drejt gjërat, pasi i janë megjulluar sytë apo i janë veshur ato, atëherë gjejnë përdorim njësitë frazeologjike: *avere la benda agli occhi/i kanë zënë sytë ag*. Të tjera shprehje në gjuhën shqipe janë: *i janë veshur sytë; iu megjulluan sytë*.

Çasti para fillimit të lotimit, pra kur jemi gati duke qarë pasqyrohet mjaft mirë nga dy njësitë *aver le lacrime agli occhi/iu njomën sytë (dikujt)*. Gjuha shqipe na paraqet një tjetër njësi sinonimike me të parën, *i lagu sytë (dikush)*.

Aguzzare gli occhi – cercare di vedere qualcosa di lontano o indistinto, guardando attentamente. É normale in questi casi socchiudere le palpebre per ridurre l'ampiezza del campo visivo a favore della sua profondità, come se gli occhi diventassero in tal modo più “aguzzi”, più penetranti. <i>Aguzzare la vista; aguzzare le ciglia.</i>	Mpreh sytë – përpiqem të shoh edhe më mirë, përqëndrohem shumë që të shoh diçka; kam kujdes të mos më ndodhë gjë. <i>Hap sytë; mpreh shikimin.</i>
Avere gli occhi foderati di prosciutto – non vedere le cose più evidenti. <i>Avere le fette di prosciutto sugli occhi; avere le fette di salame sugli occhi.</i>	I kanë vënë (i kanë zënë) sytë cergë (dikujt) - nuk e sheh qartë gjendjen rreth e rrotull, është verbuar e nuk i kupton gjërat siç janë. <i>I janë veshur sytë; i kanë vënë (i kanë zënë) sytë perde; i kanë zënë sytë lesh.</i>

Tabela 7. Të dy gjuhët paraqesin sinonimi

Në këtë nëngrup janë seleksionuar njësitë frazeologjike të cilat paraqesin sinonimi në të dy gjuhët. Siç vërejmë dhe nga tabelat të dy gjuhët paraqesin shumë shprehje sinonimike. *Aguzzare gli occhi/mpreh sytë*, i referohet një situatë ku dikush që kërkon të shohë një send apo një njeri që ndodhet paksa larg, mbyll paksa qepallat e syve në mënyrë

që të zvogëlojë fushën e shikimit me qëllim që ta bëjë atë sa më të thellë, pra të përpiket të shohë sa më larg. Njësi të tjera me të njëjtin kuptim: *aguzzare la vista/mpreh shikimin* dhe *aguzzare le ciglia* (mpreh qerpikët) dhe *hap sytë*.

Avere gli occhi foderati di prosciutto/i kanë vënë (zënë) sytë cergë, i referohet dikujt i cili nuk arrin të shohë gjërat ashtu siç janë, edhe ato më të qarta, pasi i ka sytë e zëna. Në gjuhën italiane sytë janë të zënë nga fetat e proshutës ndërsa në gjuhën shqipe sytë kanë zënë cipë apo perde, megjithatë kuptimi i shprehur është i njëjtë, duke qenë se përpara syve ka diçka që e pengon shikimin, kështu që i fundit nuk mund të jetë i qartë. Të tjera variante në gjuhën italiane janë: *avere le fette di prosciutto sugli occhi* (të kesh fetat e proshutës mbi sy); *avere le fette di salame sugli occhi* (të kesh fetat e sallamit mbi sy) ndërsa në gjuhën shqipe kemi shprehjet: *i janë veshur sytë; i kanë vënë (i kanë zënë) sytë perde; i kanë zënë sytë lesh*.

4. Në grupin e katërt vijojmë sërish me shprehjet frazeologjike me kuptim të pjesshëm. Këtu kemi seleksionuar ato njësi frazeologjike të cilat kanë strukturë morfosintaksore të njëjtë ose të ngjashme, zgjedhje leksikore të njëjtë, imazhi që përfaqësojnë është i njëjtë ose i ngjashëm, por kuptimi i tyre nuk është i njëjtë. E thënë ndryshe, njëra nga të dy gjuhët shfaq një kuptim më tepër, të dytë apo të tretë, që gjuha tjetër nuk e ka. Edhe këtu do të kemi ndarje në nëngrupe duke u bazuar tek kuptimi:

Aprire gli occhi – rendersi conto di una verità generalmente spiacevole che non si era immaginata prima, e in particolare di avere sbagliato la valutazione di qualcosa, in genere riferito a persone false o fraudolente; vale anche per le situazioni che si scoprono più rischiose di quanto si pensava.	Hap sytë – çuditem nga diçka e papritur, befasohem; kam kujdes të mos më ndodhë gjë, jam syçelë; arsimohem, marr dije e njohuri.
Aprire gli occhi a qualcuno – rivelare a qualcuno una realtà che non conosceva, in genere spiacevole; in particolare, indurre una persona a rendersi conto della possibilità di un inganno, della pericolosità di una situazione, delle vere intenzioni di qualcuno e così via.	I hap sytë dikujt – i jap dije a kulturë, i zgjeroj horizontin, e zhvilloj; e bëj t'i shohë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë, i zbuloj të vërtetën, e bëj të kuptojë si qëndron puna.

Tabela 8. Gjuha italiane paraqet kuptim të pjesshëm në krahasim me gjuhën shqipe

Në këtë nëngrup kaq interesant do të analizojmë njësitë frazeologjike në imtësinë e kuptimeve të shumta që ato mbartin duke kuptuar më mirë vlerat e secilit komb të shprehura përmes gjuhës. *Aprire gli occhi* apo *hap sytë* i referohen dikujt i cili zbulon se mendimet apo ajo çka ka besuar deri më tani lidhur me një çështje apo me një njeri tjetër ka qenë e gabuar dhe e pavërtetë. Mund t'i referohet edhe një situatë të rrezikshme

në të cilën duhet bërë mjaft kujdes kështu që duhen hapur mirë sytë në mënyrë që të minimizohet apo parandalohet rreziku. Kuptimi i tretë që në këtë rast vetëm gjuha shqipe e mbart është të arsimohesh, të shkollohesh. Pra njësia në gjuhën shqipe, hap sytë, mund t'i referohet edhe dikujt që rishtazi ka filluar të shkollohet, të marrë dije e kulturë. Ky kuptim nuk është i shprehur nga njësia frazeologjike në gjuhën italiane.

E njëjta shprehje por tanimë kur i referohet dikujt tjetër, mbart të njëjtat kuptime. *Aprire gli occhi a qualcuno/i hap sytë dikujt*, në këtë rast jemi ne ata që përpiqemi të bëjmë dikë të kuptojë se si janë gjërat në të vërtetë, duke i shpjeguar dhe treguar qëllimet e vërteta të dikujt që hiqet si njeri i mirë por që në të vërtetë nuk është, apo për t'i treguar se si një situatë nuk është ashtu siç ai e mendon. Edhe këtu gjuha shqipe mbart një kuptim më shumë, atëherë kur përpiqemi t'i hapim sytë dikujt duke i dhënë dije a kulturë, duke i zgjeruar horizontin e duke e zhvilluar më tej atë.

Avere un'occhio alla padella e uno al gatto – badare contemporaneamente a due cose, persone o situazioni che richiedono uguale sorveglianza o che potrebbero entrare in conflitto tra loro.	I bëri sytë katër – shikonte me kujdes të madh që të mos i shpëtonte asgjë, rrinte syhapët.
Parlare con gli occhi – avere gli occhi molto espressivi, capaci di trasmettere sensazioni, emozioni, e in generale quello che si pensa. Anche comunicare qualcosa ad un'altra persona con l'espressione degli occhi, senza che gli altri altri se ne accorgano. Oppure, non riuscire a nascondere quello che si pensa.	Flet me sy e me vetulla – kur flet i lëviz shumë sytë e vetullat; bashkë me fjalët përdor edhe lëvizjet e syve e të fytyrës për të shprehur mendimet e ndjenjat e veta.

Tabela 9. Gjuha shqipe shfaq kuptim të pjesshëm në lidhje me gjuhën italiane

Në këtë nëngrup kemi seleksionuar shprehjet frazeologjike të cilat në gjuhën italiane shfaqin një apo disa kuptime më shumë se gjuha shqipe. *Avere un'occhio alla padella e uno al gatto/i bëri sytë katër*, po të shohim strukturën e shprehjeve do të kuptojmë se nuk është e njëjtë, por duke qenë se kuptimi i shprehur nga njësia në gjuhën italiane mbart disa elementë që gjuha shqipe nuk i ka, e menduam me vend ta vendosnim këtu këtë njësi frazeologjike. T'i bësh sytë katër do të thotë të jesh shumë i kujdesshëm në mënyrë që të mos shpëtojë asgjë. Të dyfishosh numrin e syve bëhet me qëllimin e vetëm që të mund të shohësh më mirë e kështu të jesh më i vëmendshëm. Ndërsa në gjuhën italiane t'i hedhësh një sy tiganit dhe një tjetër maces do të thotë jo vetëm të jesh shumë i vëmendshëm për atë që ndodh rreth e rrotull, por mbi të gjitha të kesh shumë kujdes pasi palët mund të futen në konflikt njëri me tjetrin.

Parlare con gli occhi do të thotë të kesh sy që janë në gjendje të shprehin ndjenja apo të arrijnë të komunikojnë edhe pa qenë nevoja të përdoren fjalët. Në gjuhën shqipe, gjegjësjë është relativisht e ndryshme në strukturë, *flet me sy e vetulla*, që i referohet dikujt i cili kur flet është mjaft ekspresiv dhe së bashku me fjalët përdor edhe sytë e vetullat për të shprehur ndjenjat apo emocionet. Kur sytë flasin apo qeshin është pak e vështirë që vetullat të rrinë pa lëvizur, ndoshta për këtë arsye është zgjedhur edhe përdorimi i elementit vetull krahas syve. Kuptimi tjetër që mbart shprehja në gjuhën italiane është se dikush që ka sy që flasin vetë, i përdor këto të fundit për t'i komunikuar dikujt diçka në prani të njerëzve të tjerë pa qenë e nevojshme që këta të fundit ta marrin vesh. Apo situata e kundërt, kur dikujt i flasin sytë është vështirë që të mund të arrijë të fshehë ndjenjat e tij të vërteta para njerëzve të tjerë.

5. Në grupin e pestë kemi seleksionuar njësitë frazeologjike me kuptim të njëjtë, imazh të njëjtë ose të ngjashëm, por me strukturë morfosintaksore dhe zgjedhje leksikore të ndryshme. Elementi që e dallon këtë grup përveç kuptimit është imazhi që njësitë frazeologjike pasqyrojnë:

Aprire gli occhi ai ciechi - indurre qualcuno a rendersi conto di qualcosa, in genere spiacevole. Anche insegnare, spiegare, far capire qualcosa d'importante.	I hap sytë dikujt – i jap dije a kulturë, i zgjeroj horizontin, e zhvilloj; e bëj t'i shohë gjërat ashtu siç janë në të vërtetë, i zbuloj të vërtetën, e bëj të kuptojë si qëndron puna.
Avere ancora negli occhi – avere un vivo ricordo di qualcosa, come se lo si avesse ancora davanti agli occhi o vi fosse rimasto dentro.	Më del para syve (dikush a diçka) – e përfytyroj qartë, sikur e shoh tani; më kujtohet mirë.

Tabela 10. Ndryshime në imazhin e pasqyruar

Aprire gli occhi ai ciechi/i hap sytë dikujt, këtu kemi të bëjmë me dy kuptime të mbartura nga njësitë frazeologjike të njëjta për të dy gjuhët. Së pari këto shprehje i referohen një situatë ku dikujt i flasim me sinjeritet dhe e bëjmë të kuptojë si janë gjërat në të vërtetë, zakonisht përdoret për t'i treguar dikujt diçka të pakëndshme. Kuptimi tjetër i shprehur i referohet rastit kur dikujt i japim dije a kulturë apo i mësojmë diçka të rëndësishme, e bëjmë ta kuptojë atë.

Kur dikë apo diçka nuk e kemi më pranë, por kujtimi i tij është kaq i gjallë saqë duket sikur në të vërtetë na gjendet përballë, para syve, përdoren shprehjet *avere ancora negli occhi/më del para syve* (dikush a diçka). Imazhi i përfytyruar nga gjuha italiane është ta kesh kujtimin brenda në sy, pasi aq i gjallë është ky i fundit saqë duket sikur ka ngelur brenda syve e nuk ka dalë më prej tyre.

6. Në grupin e gjashtë kemi njësitë frazeologjike të cilat paraqesin vetëm një element të përbashkët, kuptimin që vijon të jetë i njëjtë. Ndërsa tre elementët e tjerë: imazhi, struktura morfosintaksore dhe zgjedhja leksikore, tek të cilët jemi bazuar për të mundësuar analizën tonë, janë të ndryshme.

Anche l'occhio vuole la sua parte – si dice quando si desidera che qualcosa, oltre a essere utile, possa appagare anche il senso estetico.	E ha syri (diçka) – e pëlqen nga pamja e jashtme, e pranon.
Costare un occhio – riferito a concetti come spendere, valere, pagare e simili, indica una somma di denaro molto elevata. <i>Costare un occhio della testa.</i>	(Kushton) sa qimet e kokës – jep një çmim jashtëzakonisht shumë të lartë; e mban shumë shtrenjtë diçka.

Tabela 11. Ekuivalencë vetëm në kuptim

Anche l'occhio vuole la sua parte, do të thotë se diçka përveçse duhet të jetë e dobishme është mirë që të plotësojë edhe kriterin estetik, pra të jetë e kënaqshme për syrin, pikërisht nga ky arsyetim lind shprehja *edhe syri do pjesën e tij*. Në shqip gjegjësen e kemi *e ha syri*, pra kur syri e pranon diçka si të pëlqyeshme, njësoj si goja që e ha diçka pasi e pëlqen.

Costare un occhio i referohet një situatë ku për të pasur diçka duhet të paguajmë një shumë të konsiderueshme, mjaft të kripur aq sa mund të themi se diçka ka vlerë të paçmueshme, pra kushton shumë aq sa mund të kushtojë një sy. Po kështu në shqip gjegjësjë kushton sa qimet e kokës jep të njëjtin kuptim. Është mjaft interesante të kuptojmë këtu veçantitë e dy gjuhëve, nëse për italianët një çmim jashtëzakonisht shumë i lartë barasvlerësohet me çmimin e një syri, në gjuhën shqipe kjo vlerësohet me çmimin e qimeve të kokës. Një tjetër variant i kësaj shprehje në gjuhën italiane është *costare un occhio della testa*.

7. Në grupin e shtatë dhe të fundit mbërrimë tek ekuivalenca zero e shprehjeve në të dy gjuhët. Këtu kemi seleksionuar ato njësi frazeologjike të cilat na paraqiten me strukturë morfosintaksore të njëjtë, zgjedhje leksikore të njëjtë, imazhin e pasqyruar të njëjtë, por me kuptim të ndryshëm, herë-herë të kundërt. Pra, kuptimi, kriteri kryesor tek i cili jemi bazuar për të bërë analizën përqasëse këtu na del i ndryshëm dhe është pikërisht ky i fundit që përbën në këtë grup veçorinë dalluese:

Avere gli occhi fuori dalle orbite – essere furibondi, infuriati, con un'espressione talmente distorta dall'ira da far pensare a una fuoriuscita degli occhi dalla sua sede. <i>Avere gli occhi fuori dalla testa.</i>	I dolën sytë nga vendi (dikujt) – u zgurdullua fort nga tmerri; po heq një mundim të madh; ka shumë zor a u çudit shumë. <i>I dolën sytë jashtë; i dolën sytë dokërr; iu çapëlyen sytë.</i>
Fare gli occhi alle pulci – essere molto abili in ogni tipo di attività e lavoro, specie per quanto riguarda lavori minuziosi, di precisione o pazienza. Per estensione, anche essere eccessivamente pignoli.	I kërkon pleshtit syrin – dikush kërkon të dijë gjëra të hollësishme e të panevojshme, hyn në çikërrima.

Tabela 12. Ekuivalenca zero

Avere gli occhi fuori dalle orbite/i dolën sytë nga vendi (dikujt), këtu kemi të bëjmë me strukturë të njëjtë, por me kuptim të ndryshëm. Në gjuhën italiane të të dalin sytë nga vendi ndodh për shkak të zemërimit që ndien dikush, e pikërisht nga ky zemërim njeriu shpërfytyrohet aq sa duket sikur sytë nuk i ka më në vendin e tyre. Për gjuhën shqipe, shkak i daljes së syve nga vendi i tyre verifikohet atëherë kur dikush tmerrohet aq shumë sa i zgurdullohen sytë.

Fare gli occhi alle pulci, t'i bësh pleshtit sytë, do të thotë të jesh shumë i përpiktë në çdo punë që kryen sidomos në ato punë që kërkojnë saktësi shumë të madhe, edhe të jesh pedant, të merresh me vogëlsira e hollësira. Ndërsa në gjuhën shqipe *i kërkon pleshtit syrin*, do të thotë të jesh i bezdisur e të kërkojë të dish vogëlsira e çikërrima, të merresh me gjëra të hollësishme e të panevojshme të cilat kryhen nga të tjerët. Pra nëse në gjuhën italiane është vetë njeriu që i zbaton gjërat me përpikëri nga ana formale, në gjuhën shqipe është ai që interesohet për punën e të tjerëve në detaje.

Përfundime

Qëllimi i këtij punimi mbetet, së pari, përcaktimi i kriterëve që mundësojnë krahasimin e njësive frazeologjike në të dy gjuhët, italiane dhe shqipe dhe nxjerrjen në pah të tipareve themelore të njësive frazeologjike, të tilla si qëndrueshmëria, leksikalizimi, idiomaticiteti. Këto tipare të analizuara dhe të qartësuara përmes punimit dëshmojnë afërsinë kulturore dhe të *formamentis* të të dy popujve që ndajnë ndjesi, mendime dhe reagime shpeshherë të njëjta dhe shpeshherë me ndryshime të vogla hera herës thelbësore.

Për të krahasuar dy sistemet frazeologjike u bazuam në 4 kriterë: kuptimi, struktura, imazhi dhe zgjedhja leksikore. Arritëm të ndërtojmë 7 nivele krahasimi, bazuar tek

kriteret e lartpërmendur, duke nisur nga grupi i parë, tek i cili ishin klasifikuar njësitë me ekuivalencë totale, për të vijuar me njësitë frazeologjike me ekuivalencë të pjesshme nga grupi i dytë deri tek ai i pestë, për të përfunduar me njësitë me ekuivalencë zero tek grupi i shtatë. Ky punim evidentoi se njësitë frazeologjike me ekuivalencë të pjesshme janë më të shumta në numër, duke përcjellë ndryshime në strukturën morfosintaksore, në zgjedhjen leksikore, në imazhin e pasqyruar dhe së fundmi pjesërisht në kuptimin që këto të fundit mbartin.

Në përfundim të analizës tonë duam të theksojmë se mbi të gjitha janë pikërisht faktorët ekstragjuhësorë, pra ata sociokulturorë, përcaktues të drejtpërdrejtë në një shkallë shumë të lartë të të gjithë procesit të idiomaticitetit, aspekt ky mjaft i rëndësishëm në krahasimin e sistemeve gjuhësore frazeologjike në përgjithësi dhe atij të marrë në shqyrtim nga kjo trajtesë në veçanti. Prania e këtyre të fundit përlligj dallimet në mendësi, traditë e kulturë. Megjithë shkallën e ndryshme të zhvillimit ekonomiko-kulturor, megjithë përkatësinë e ndryshme në familjet e gjuhëve duhet pranuar se janë të shumtë elementët që i lidhin dhe i bashkojnë këto dy gjuhë, dëshmuar kjo edhe përmes studimit të këtyre njërive frazeologjike.

BIBLIOGRAFIA

- Akademia e Shkencave të Shqipërisë. *Fjalori i shqipes së sotme*. Tiranë: Botimet Toena; 2002.
- Balla, Naim. & Ymeri Eshref. & Lama, Irena. *Dizionario maggiore dei modi di dire italiano-albanese*. Tiranë: EDFA; 2007.
- Çabej, Egerem. *Parallele Ausdrücke und Redensarten in den Balkansprachen*. Revue internationale des études balkaniques. 1936; 3; 172-184.
- Casadei, Federica. *Metafore ed espressioni idiomatiche. Uno studio semantico sull'italiano*. Roma: Bulzoni, 1996.
- Lo Zingarelli. *Dizionario della lingua italiana*. Bologna: Zanichelli; 2012.
- Navarro, Carmen. *Fraseología contrastiva del español y el italiano (análisis de un corpus bilingüe)*, Variis Linguis, Verona, 2004, p. 397- 411.
- Quartu, Bruno. *Dizionario dei modi di dire della lingua italiana*. Milano: Bur; 2001.
- Raffo, Anton. *Balkanismi e non*. Europa Orientalis 8. Contributi italiani al VI Congresso Internazionale di studi Sud-Est-Europei. 1989, 199-207.
- Thomai, Jani. *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë: Shkenca; 1999.
- Thomai, Jani. *Leksikologjia e gjuhës shqipe*. Tiranë: Botimet Toena; 2006.
- Wotjak, Barbara and Ginsburg Carla. *Zu Interlingualen Äquivalenzbeziehungen bei verbalen Praseolexemen*. "Das Wort: Germanistisches Jahrbuch DDR-UdssR". 1987, 67-78.